Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 MMPHI gjatë vitit kishte realizuar pagesa në vlerë prej 827,990€ nga kategori ekonomike jo adekuate.

B1 MMPHI kishte realizuar pagesa në vlerë 298,142€ për 64 të punësuar me Marrëveshje të Brukselit të cilët nuk kanë objektiva të punës, nuk janë të sistemuar dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në ministri.

B2 Vlera e pasurisë e prezantuar në PVF nuk ishte e saktë si rezultat i regjistrimit të gabuar (ndër vite) të shpenzimeve për mirëmbajtje të rrugëve në vlerë 71,801,641€ në SIMFK në kategorinë investim në vijim pa e përmbushur kushtin për tu cilësuar si të tilla, regjistrimit të gabuar të disa pasurive jo kapitale në SIMFK në vlerë 227,826€ si dhe mos-regjistrimit të pasurive në vlerë 14,409,506€.

B3 Si rezultat i mos-bartjes së pronësisë së projekteve të përfunduara për komuna, mos-regjistrimit të pasurive në përdorim në klasën adekuate si dhe mos-aplikimit të normës së saktë të zhvlerësimit, pasuria kapitale ishte mbivlerësuar për 4,772,582€.

B4 Vlera e obligimeve në PVF ishte nënvlerësuar për 1,590,636€ si rezultat i mos-shpalosjes së plotë të tyre, ndërsa në anën tjetër ishte mbivlerësuar për 41,898€ si rezultat i paraqitjes së një obligimi që nuk i takonte vitit aktual.

B5 Detyrimet kontingjente të shpalosura në PVF ishin të mbivlerësuara për 26,107,774€ .

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës nuk kanë qenë në përputhje me:

Baza për konkluzion

A2 Në dy raste nuk ishin aplikuar procedurat adekuate të prokurimit.

A3 Si rezultat i mos-respektimit të kritereve të vendosura në dosje të tenderit gjatë vlerësimit të ofertave është eliminuar Operatori Ekonomik që kishte ofertën më të lirë.

A4 Në 40 raste të pagesave nuk ishin zbatuar hapat për procedim të pagesave siç kërkohet me rregulloren e aplikueshme.

A5 Ministria kishte realizuar shpenzime jashtë kontratës në vlerë 38,250€.

B6 Tek pesë projekte ishin bërë ndryshime në sasitë e realizuara në raport me paramasën e kontraktuar pa aprovime paraprake dhe si rezultat te këto projekte kishte tejkalim të realizimit të sasive të kontraktuara në vlerë të përbashkët prej 658,560€ (pa u tejkaluar vlera e kontratës).

B7 Në 14 raste pagesat në vlerë 1,902,192€ ishin realizuar pas afatit kohorë ligjorë prej 30 ditësh. Vonesat variojnë nga një deri në shtatë muaj.

C1 Përdorimi i kontratave jo adekuate ka shkaktuar tejkalim të vlerës së tyre në raport me vlerën e parashikuar. Ky tejkalim për 6 kontrata (llote) të testuar ishte 3,327,204€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

1 Vlen të theksohet se struktura organizative e ministrisë gjatë vitit 2021 kishte pësuar ndryshime me hyrjen në fuqi të "Rregullores (qrk) - nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive" me të cilën është themeluar "Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës" (MMPHI) si rezultat i bashkimit të ish "Ministrisë së Infrastrukturës" me ish "Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor" që para ri-strukturimit kishte funskionuar si "Ministri e Ekonomisë dhe Ambientit" (MEA).

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Kontrollet sa i përket menaxhimit financiar gjatë vitit 2021 kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për t'i parandaluar mangësitë në shpalosje dhe kryerjen e pagesave në mos-pajtueshmëri me legjislacionin e zbatueshëm dhe autoritetet.

Fushat që kërkojnë më tepër fokus janë menaxhimi i pasurisë, klasifikimi i shpenzimeve si dhe shpalosja e plotë dhe e drejtë e gjendjes së obligimeve dhe detyrimeve kontigjente. Në mungesë të kontrolleve efektive në këto fusha kemi një prezantim jo të saktë dhe të plotë të vlerave të raportuara në PVF. Në kontekst të pagesave kujdes i shtuar duhet t'i kushtohet vonesave në pagesa si dhe realizimit të punëve në përputhje me kushtet e kontraktuara. Po ashtu, të evitohen dobësitë në fushën e prokurimit dhe të përdoren praktikat më të mira për tu arritur vlera për paranë.

Veprime shtesë janë të domosdoshme në menaxhimin dhe implementimin e projekteve kapitale ku mangësitë në hartimin e projekteve dhe vonesat në realizimin e tyre ishin shumë të theksuara. Si rezultat i projekteve të mangëta, ishte nënshkruar një numër i madh i anekseve për punë shtesë gjatë vitit 2021 duke tejkaluar kostot fillestare të planifikuara për projekte.

Sa i përket menaxhimit të pagave dhe mëditjeve, mbetet sfiduese çështja e sistemimit dhe angazhimit të të punësuarve të komunitetit serb me "Marrëveshje të Brukselit" të cilët kompensohen ndër vite pa zhvilluar asnjë aktivitet në ministri.

Gjetjet dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 25 rekomandime, prej tyre 10 janë rekomandime të reja, 13 rekomandime të përsëritura dhe 2 rekomandime pjesërisht të përsëritura. Nga rekomandimet e reja 4 rekomandime janë të bartura (të përsëritura) që i takojnë ish "Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor" e cila para ndryshimeve strukturore të ministrisë kishte funksionuar si "Ministri e Ekonomisë dhe Ambientit" (MEA). Këto rekomadime janë hapur si çështje të reja në këtë raport duke qenë se kemi të bëjmë me një subjekt të ri në raport me vitin paraprak, dhe të njëjtat janë mbyllur në "Ministrinë e Ekonomisë" (ME). Rekomandimet e ngjashme nga viti paraprak për të dy ministritë e bashkuara në MMPHI janë integruar tek çështjet e përsëritura.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të rregullës financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Lidhur me këtë nga mostrat e testuara kemi identifikuar se:

- Dy pagesa për mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve në vlerë totale 485,295€, ishin realizuar nga kategoria e investimeve kapitale edhe pse për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.
- Po ashtu nga kjo kategori, ishte realizuar një pagesë në vlerë 221,000€ për "Furnizim me kontejner" që për nga natyra furnizimi i takon kategorisë mallra dhe shërbime pasi që çmimi për njësi për kontejner ishte 17€.
- Ndërsa, pagesat për "Furnizim me klima" dhe "Mirëmbajtje dhe renovim i stacioneve hidrometrike të Kosovës sipas pellgjeve", në vlerë totale 121,685€ ishin realizuar nga kategoria mallra dhe shërbime edhe pse për nga natyra këto shpenzime i takojnë kategorisë së Investimeve kapitale.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme, ndërsa në rastin e pagesave për mirëmbajtje të rrugëve, shpenzimet ishin të buxhetuara në kategorinë e investimeve kapitale.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate ekonomike ndikojnë në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar informata jo të sakta për lexuesit e PFV. Po ashtu, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike jo adekuate për këto shpenzime.

Rekomandimi A1

Ministri duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit si dhe pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ri-destinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë

Gjetja

Neni 8 i rregullores (QRK) Nr.12/2020 Për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve", përcakton se "Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik". Poashtu, neni 43.2 i Ligjit nr. 06/L – 114 për zyrtar publik thekson që "Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuara në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit".

Me vendimin nr. 06/39 të datës 22.07.2015, Qeveria e Kosovës ka aprovuar konkluzionet e dakorduara të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për realizimin e marrëveshjes së ashtuquajtur "Mbrojta Civile". Në kuadër të kësaj marrëveshje për integrim, në MMPHI përmes akt-emërimeve janë të punësuar 64 punonjës të komunitetit serb të cilët marrin paga të rregullta. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët e Ministrisë këta të punësuar nuk kanë hapësira të përcaktuara të punës, nuk kanë objektiva të përcaktuara dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për vitin 2021 ishte 298,142€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi po raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmerr masa konkrete në sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

Ndikimi

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të parregullta dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi B1

Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për angazhimin e këtyre të punësuarve duke siguruar kushte pune, duke përcaktuar objektiva të qarta të punës si dhe të siguroj monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mangësi në procesin e regjistrimit të pasurive në regjistrin kontabël

Gjetja

Neni 6.1 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agruar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël. Si dhe pika 3 përcakton se 'Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Ne kemi identifikuar pasuri të paregjistruara që i takojnë pagesave të vitit 2021 si dhe pasuri të paregjistruara për të cilat është rekomanduar në vitin paraprak por nuk ishte ndërmarrë asnjë masë për regjistrimin e tyre si:

- Mos-regjistrimi i 26 pagesave të realizuara në vitin 2021 për projekte të ndryshme nga kategoria e investimeve kapitale në regjistrin SIMFK në vlerë 14,242,722€ të cilat kanë shkaktuar nënvlerësim të gjendjes reale të pasurisë;
- Mos-regjistrimit në SIMFK të katër (4) automjeteve të dhuruara si donacion gjatë vitit 2020 në vlerë totale prej 134,012€ si dhe dy veturave të blera në vitin 2019 në vlerë totale prej 53,657€. Pasuria në vlerë neto e nënvlerësuar si rezultat i mos-regjistrimit të këtyre veturave ishte 154,154€;
- Regjistrimit të gabuar të dy pagesave në vlerë 227,826€ që i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime duke shkaktuar mbivlerësim të pasurisë kapitale; si dhe
- Mos-regjistrimit të pasurive jo kapitale, përkatësisht 3 pagesave për furnizim me kompjuter në vlerë totale 12,630€ në sistemin E-pasuria.

Më tutje, neni 15 paragrafi 3 i rregullores 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurive Jo-financiare tek Organizatat Buxhetore thekson se ''Kostoja e mirëmbajtjes së pasurive kapitale nuk konsiderohet përmirësim dhe si e tillë, nuk regjistrohet si shpenzim kapital''. Po ashtu, neni 7 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ 04/2019 -Për Definimin e Projekteve Kapitale dhe Klasifikimin e Shpenzimeve Kapitale përcakton se "Shpenzimi pasues në përsëritjen e aktivitetit/procesit të projektit ose korrigjimin e aktivitetit, i cili nuk siguron përfitim ekonomik në të ardhmen përtej atij që ndërlidhet me shpenzimin origjinal, trajtohet si shpenzim rrjedhës".

- Në regjistrin SIMFK janë të regjistruara si investime në vijim pagesat e realizuara për mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve në vlerë 71,801,641€ (të gjitha pagesat e regjistruara nga viti 2015 deri në fund të vitit 2021) edhe pse ato nuk e plotësojnë kushtin sipas kërkesave rregullative për tu trajtuar si pasuri respektivisht investime në vijim. Lidhur me këtë çështje është rekomanduar edhe në vitin paraprak por Ministria nuk kishte ndërmarr masa dhe kishte vazhduar t'i regjistroj këto shpenzime si investim në vijim edhe në vitin 2021.

Mos regjistrimi i pasurive në SIMFK dhe E-pasuria ka ndodhur në mungesë të Zyrtarit të Pasurisë i cili është angazhuar në fund të vitit 2021 dhe nuk ka arritur ti regjistroj pasuritë brenda afatit të paraparë kohor, ndërsa mangësitë tjera të identifikuara kanë ndodhur në mungesë të kontrolleve të brendshme në këtë fushë.

Ndikimi Mos-regjistrimi dhe regjistrimi i gabuar i pasurisë ka ndikuar që vlera e pasurive e prezantuar në PVF të mos jetë e saktë.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të forcoj mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar regjistrimin e saktë dhe të plotë të gjitha pasurive kapitale në pajtim me kërkesat ligjore. Po ashtu të siguroj që përmes komisioneve përkatëse të bëhet një rishikim i detajuar i regjistrit të pasurive (sidomos vlerave të regjistruara të shpenzimeve të mirëmbajtjes) në mënyrë që të korrigjohen mangësitë e identifikuara dhe të prezantohet saktë vlera e pasurive në PVF për vitin 2022.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Mbivlerësim i regjistrit të pasurisë si rezultat i mbajtjes së pasurisë si investim në vijim dhe mos bartjes së pronësisë tek komunat përkatëse

Gjetja

Neni 11 paragrafi 1 dhe 3 i Rregullores MF nr. 02/2013 Për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcakton se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim", "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi". Po ashtu neni 13 i kësaj rregulloreje përcakton se "Të gjitha transaksionet e krijuara gjatë blerjes apo ndërtimit të pasurisë jo financiare për organizatat tjera buxhetore duhet të regjistrohen në regjistrat e organizatës financuese në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, organizata buxhetore financuese do të mbyll llogarinë e investimeve në vijim. Organizata buxhetore pranuese, pasurinë jo financiare të pranuar do ta regjistroj në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj". Po ashtu memorandumet e bashkëfinancimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përcaktojnë që me pranim dorëzimin e punëve të kryera nga OE projekti do të kaloj në pronësi të komunës.

Lidhur me këtë kemi identifikuar se:

- Ministria vazhdon t'i mbajë si invesime në vijim tetë (8) projekte kapitale [5] në vlerë totale 11,837,219€, të cilat kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i tyre. Si rezultat i regjistrimit të tyre në klasën joadekuate dhe mos aplikimit të zhvlerësimit, pasuria ishte e mbivlerësuar në efektin neto për 1,214,712€.
- Po ashtu, ministria vazhdon ti mbajë si investime në vijim shtatë (7) projekte të përfunduara [5] me raport të pranimit teknik për komuna në vlerë 3,383,645€ duke mos bartur pronësinë në komunat përkatëse. Si rezultat pasuria e ministrisë është e mbivlerësuar për vlerën e këtyre projekteve.

Më tutje, neni 6 i Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare të Organizatave Buxhetore, parasheh se: "Çdo organizatë buxhetore duhet të krijoj dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuar në bazë të planit kontabël". Po ashtu, neni 22 thekson se: "Të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit". Ky nen i rregullores përcakton edhe normat e zhvlerësimit për secilin kategori të pasurive.

Lidhur me këtë kemi identifikuar se:

Në regjistrin e pasurive në SIMFK, katër (4) pagesa të regjistruara në vitin 2006 "Rehabilitimi i rrugëve Kamenicë Tushec" ishin regjistruar në klasën e pasurive "Struktura tjera" ku norma e zhvlerësimit është 40 vite dhe jo në klasën "Ndërtimi i Rrugëve" me normë të zhvlerësimit 20 vite, siç përcaktohet me rregulloren e pasurive. Gjithashtu, një pajisje "Set i GPS dhe Smart Rover Real Time", ishte regjistruar në vitin 2009 në klasën "Ndërtimi i rrugëve" me normë të zhvlerësimit 20 vite, ndërsa do të duhej të regjistrohej në klasën "Pajisje tjera" me normë të zhvlerësimit 6 vite.

Si rezultat i gabimeve në regjistrime këto pasuri janë të mbivlerësuara për

174,225€ për shkak të përcaktimit të gabuar të normës së zhvlerësimit. Lidhur me këto pasuri është rekomanduar edhe në vitin paraprak por nuk ishte ndërmarr asnjë masë për korrigjim të tyre.

Mangësitë e identifikuara kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive.

Ndikimi

Mbajtja e pasurive kapitale si investime në vijim, përkundër faktit që ato plotësonin kriterin për tu klasifikuar si pasuri në përdorim si dhe mos bartja e pronësisë së pasurive tek komunat ashtu siç parashihet me rregullore si dhe regjistrimi i pasurive në klasën e gabuar të pasurisë ka shkaktuar mbivlerësimin e pasurive kapitale.

Rekomandimi B3

Ministri duhet të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për komuna, të barten tek komunat përfituese duke i larguar nga regjistrat e ministrisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Shpalosja jo e drejtë e obligimeve të papaguara në PVF

Gjetja

Sipas, Nenit 17 të Rregullores nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar "Organizatat buxhetore raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues".

Vlera e obligimeve në PVF nuk ishte prezantuar saktë. Ne kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Marrëveshja gjyqësore lidhur me pagesën e obligimit për shpronësim në vlerë prej 1,348,000 i cili do të duhej të paguhej në shkurt dhe mars 2022, nuk ishte prezantuar në pasqyra. Po ashtu obligimi lidhur me shpronësim në vlerë prej 59,895€ ishte prezantuar në vlerën 43,065€ duke e nënvlerësuar obligimin real për 16,830€ si rezultat i gabimit gjatë kalkulimeve.
- Ministria kishte pranuar tri fatura në vlerë 225,806€ në dhjetor të vitit 2021 ndërsa pagesat ishin kryer në shkurt 2022 dhe këto obligime nuk ishin prezantuar në PVF.
- Në një rast ministria kishte pranuar faturën në vlerë 41,898€ në janar të vitit 2022 dhe ky obligim ishte prezantuar në PVF 2021, duke mbivlerësuar kështu obligimet e përgjithshme për 41,898€.

Mangësitë e identifikuara janë rezultat i mungesës së kontrolleve të mjaftueshme në evidentim dhe raportim të obligimeve.

Ndikimi

Kontrollet e dobëta në menaxhimin dhe raportimin e obligimeve, paraqesin shpalosje jo të drejtë të obligimeve në PVF.

Rekomandimi B4

Ministri duhet të siguroj se kontrollet në zyrën e financave janë plotësisht efektive në mënyrë që të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontigjente në PVF

Gjetja

Sipas nenit 18 të Rregullores nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, "Organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente".

Detyrimet kontingjente të prezantuara në nenin 18 në Raportin Vjetor Financiar për vitin 2021, ishin mbivlerësuar për 26,107,774€ si rezultat mangësive në vijim:

- Ministria në katër raste në vlerë 4,507,758€ kishte prezantuar si detyrime kontigjente lëndët për të cilat ishin bërë pagesa;
- Në katër raste në vlerë prej 3,542,916€ ekzistonte pajtimi gjyqësor lidhur me mënyrën e pagesës;
- Në tri raste tjera në vlerë prej 5,948,027 ekzistonte urdhëri përmbarimor; në një rast në vlerë prej 85,551€ lënda ka të bëjë vetëm me kërkesë për ofrimin e informatave nga gjykata dhe jo me padi ndaj ministrisë;
- Në tri raste në vlerë prej 31,306€ Gjykata e apelit kishte vendosur në favor të palës paditëse dhe nuk është ofruar ndonjë dëshmi se lënda është kthyer në rigjykim;
- Në dy raste kemi vërejtur se Ministria kishte dyfishura detyrimet kontigjente në vlerë prej 1,334,123€ si rezultat i prezantimit të tyre dy here;
- Në dy raste sipas dokumenteve burimore vlera e detyrimeve kontigjente ishte 24,959€ ndërsa në regjistër ishte prezantuar në vlerë prej 10,404,583€; si dhe
- Në katër raste pasuritë kontigjente në vlerë totale prej 278,469€ ishin prezantuar si detyrime kontigjente.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së vëmendjes nga zyrtarët të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente si dhe pa mjaftueshmërisë së kontrollit të brendshëm gjatë procedimit të lëndëve për raportimin e detyrimeve kontingjente në PVF.

Ndikimi

Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve, njëherësh ndikon në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.

Rekomandimi B5

Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A2 - Përdorimi i procedurës jo adekuate të prokurimit

Gjetja

Dispozitat ligjore të Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, përcaktojnë procedurat lidhur me zhvillimin e procedurave të prokurimit dhe llojet e kontratave. Neni 18.27 dosja e tenderit, në rast të aplikimit të kontratës kornizë ku sasitë mund të mos jenë parashikuar në mënyrë precize një parashikim i përafërt i sasive duhet të përfshihet. Parashikimi i tillë i përafërt mund të bazohet në konsumin e mëhershëm duke e korrigjuar me variacionet e njohura sipas nevojës. Sasitë duhet të kenë për aq sa është e mundur afatet e dorëzimit. Si dhe, neni 56.10 i rregullores përcakton që Kontrata publike kornizë" nënkupton një marrëveshje për një periudhë të kufizuar në mes të një apo me shume autoriteteve kontraktuese. Sasia e parashikuar e specifikuar në dokumentet e tenderit është vetëm sasi indikative.

Lidhur me këtë kemi identifikuar mangësitë në vijim:

- Në procedurën e prokurimit e iniciuar me datë 28.06.2019 " Hartimi i projektit zbatues për ndërtimin e shtratit të lumit Drini i Bardhë përgjatë autostradës Istog-Peje-Deçan-Gjakovë-Prizren L 14.20km", ministria nuk kishte aplikuar procedurën adekuate në pajtim me fushëveprimin e aktivitetit të projektit të prokurimit, kështu duke përdorur procedurën kontratë publike kornizë (devijim në sasi +-30) për projektin i cili kishte të përcaktuar saktë sasitë nga njësia kërkuese. Ministria për këtë procedurë kishte lidhur kontratë kornizë me dt. 06.01.2021 me vlerë indikativ prej 415,230€,
- Poashtu, në procedurën e prokurimit "Pastrimi dhe Mirëmbajtja e zyrave të AMMK-së" në vlerë totale indikative të kontratës 49,280€, ishte aplikuar kontrata publike kornizë duke u lejuar devijimi +/- 30% edhe pse sasitë dhe çmimet e kontraktuara të shërbimit ishin të përcaktuara në mënyrë precize dhe vlera e paraparë e pagesës mujore ishte fikse.

Këto mangësi gjatë procesit të prokurimit kishin ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të duhura në fushën e prokurimit.

Ndikimi

Mosaplikimi i procedurave adekuate të prokurimit rrit rrezikun që të mos përzgjidhet oferta më e mirë, dhe përdorimi i kontratës kornizë kur dihen saktë sasitë lejon hapësirë që të ketë keq-menaxhim dhe tejkalim të vlerave të tyre.

Rekomandimi A2

Ministri duhet të sigurojë se kontrata kornizë aplikohen vetëm në rastet kur sasia e saktë nuk mund të definohet përderisa në rastet kur dihen saktë sasitë të aplikohen procedurat e duhura për dhënie të kontratës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Mangësitë në procesin e vlerësimit të ofertave për procedurat e prokurimit

Gjetja

Bazuar në nenin 18.3 të RrUOPP të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme. Ne rast se AK lejon çmime me më shume se (2) numra pas pikës dhjetore, atëherë AK duhet të cekë këtë decitivisht në Dosjen e tenderit dhe duhet të përdorë Listën e çmimeve jo-standarde i (RrUOPP) .

Ne identifikuam se në dosjen e tenderit të publikuar me datë 28.08.2020 tek procedura e prokurimit për “Furnizimi dhe montimi i ndriçimit në Autostradën Morinë-Merdare, R7”, tek kërkesat për përgatitjen e tenderit, është kërkuar që të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas presës dhjetore. Çdo numër i shënuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret për bazë në llogaritje të vlerës së ofertës.

Lidhur me këtë procedurë, komisioni i vlerësimit kishte eliminuar një OE me çmimin më të ulët me arsyen se në një pozicion kishte ofertuar me çmim me më shumë se dy numra pas pikës dhjetore. Komisioni kishte vepruar duke u bazuar në udhëzimin e prokurimit dhe nuk kishte marrë për bazë kriterin e vendosur në dosje të tenderit. Kontrata ishte nënshkruar me datë 19.03.2021 në vlerë 417,167€, ndërsa çmimi i ofertës së OE të eliminuar ishte 323,915€ apo 93,122€ më i lirë se oferta fituese.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i vendosjes së kritereve jo në pajtim të plotë me rregullat e prokurimit, duke shkaktuar paqartësi edhe tek komisioni i vlerësimit.

Ndikimi

Vendosja e kritereve të paqarta ka ndikuar në procesin e vlerësimit nga ana e komisionit, duke rekomanduar për kontratë OE me çmimin më të lartë dhe të eliminohet oferta e OE me çmim më të lirë.

Rekomandimi A3

Ministri, duhet të sigurojë se janë vendosur kontrolle efektive në fushën e prokurimit, për të siguruar vendosjen e kritereve të qarta në dosje të tenderit në përputhje me legjislacionin përkatës dhe se vlerësimi i ofertave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në dosjet e tenderit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A4 - Mangësi në procedimin e pagesave

Gjetja

Sipas Rregullës Financiare 01/2013 Shpenzimi i parave publike - fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procesohet urdhër-blerja, pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.

Nga 107 mostra të testuara në 40 raste në fillim ishte pranuar fatura, pastaj ishte bërë zotimi i mjeteve dhe ishte lëshuar urdhërblerja.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos zbatimit të procedurave për shpenzimin e parasë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës,

Ndikimi Pranimi i faturave para zotimit të mjeteve dhe urdhërblerjes, mund të ndikoj në rritjen e obligimeve për periudhat e ardhshme në rast të pamundësisë së kryerjes së pagesës nga ana e ministrisë. Kjo mund të rezultojë edhe me padi nga ana e OE.

Rekomandimi A4 Ministri duhet të vendos kontrolle të shtuara financiare dhe të siguroj se zyrtarët financiar zbatojnë me përpikëri të gjitha procedurat e shpenzimeve, dhe të gjitha faturat të paguhen sipas rregullave të përcaktuara ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Realizimi i shërbimeve jashtë kontratës

Gjetja Në kontratën "Kontraktimi i një kompanie për mbështetje DKP-së lidhur me komunikimin publik dhe zhvillimin e webfaqes së MMPH-së" e nënshkruar me datë 25.10.2018, në vlerë 127,500€ ishin të përfshira gjashtë aktivitete të cilat duhet të realizohen nga OE i kontraktuar në përputhje me çmimet e kontraktuara.

Ne kemi vërejtur se MMPHI pagesën e datës 22.03.2021 në vlerë prej 38,250€ për mirëmbajtje të teknologjisë informative e kishte realizuar në mospërputhje me këtë kontratë. Aktivitetet e faturuara për shërbimin e ofruar kishin të bënin me zhvillimin e një web-faqeje të re e që nuk ishte e përfshirë në aktivitetet e kontraktuara.

Sipas zyrtarëve përgjegjës kjo kishte ndodhur pas ndryshimeve strukturore të Ministrisë (krijimit të MMPHI) dhe paraqitjes së nevojës për krijimin e një web-faqeje të re.

Ndikimi Pranimi i shërbimeve pa kontratë mund të shkaktojë shpenzime jo në përputhje me çmimet e tregut.

Rekomandimi A5 Ministri duhet të siguroj që çdo shërbim i pranuar të jetë në përputhje me kushtet e kontraktuara si dhe për çdo ndryshim në kushtet e kontratës të siguroj se nuk anashkalohen kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B6 - Ndryshime në sasitë e paramasës për kontratat jo kornizë pa aprovimet paraprake

Gjetja Neni 61.22 dhe 61.23 të rregullave dhe UOPP theksojnë se aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit, si dhe ndryshimi i kontratës nuk do t'i lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA. Po ashtu bazuar në UA nr.2008/3 neni 10.2, për çdo ndryshim të planit dinamik si dhe pozicioneve, qoftë në përmbajtje, sasi dhe në cilësi, duhet të njoftohet Drejtoria e Rrugëve ose Departamenti i Infrastrukturës Rrugore.

Në rastet në vijim kemi identifikuar se kishte pasur ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, por pa rritur çmimin total të kontratës, pa aprovim paraprak nga ZKA dhe pa njoftim të drejtorisë së rrugëve ose departamentit të infrastrukturës rrugore:

- Për kontratën "Ndërtimi i rrugës Nacionale N2 Nadakovc-Smrekovnicë Loti 2" në vlerë 2,067,455€, kishte ndryshime të sasive të realizuara në 8 pozicione të kontratës në vlerë 75,056€. Vlera totale e kontratës nuk kishte ndryshuar, mirëpo pozicione të caktuara ishin rritur deri në 25% më shumë nga sasia e kontraktuar. Më tej, tek ky projekt sipas situacionit përfundimtar të datës 24.12.2020 kemi një mbi-pagesë për 25,000€ (pa TVSh). Kjo mbi-pagesë ishte si rezultat i kalkulimeve jo të sakta të pozicioneve të realizuara për punët "Ndriçimi publik dhe kanalizimi kabllor", (pozicionet nga 1-7) ku sipas sasive të përshkruara vlera e pozicioneve të realizuara do të duhej të ishte 42,811€, ndërsa ishte llogaritur dhe paguar vlera 68,167€. Pagesa ishte ekzekutuar me dt.12.02.2021. Pas identifikimit të këtij rasti gjatë auditimit, Ministria ka ndërmarrë masa dhe mjetet në vlerë prej 29,500€ (përfshirë TVSh-në) janë kthyer në buxhetin e ministrisë nga operatori ekonomik.
- Tek projekti " Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve Nacionale dhe regjionale -Mitrovica 2" në vlerë 574,015€, kishte ndryshim të sasive të realizuara në 5 pozicione në vlerë 4,995€. Vlera e kontratës nuk ishte ndryshuar por pozicione te caktuara ishin rritur deri në 9% më shumë nga sasia e kontraktuar.

Më tutje, neni 4.7 i memorandumeve të mirëkuptimit të lidhura në mes të ministrisë dhe komunave përkatëse, përcakton se komuna është e obliguar që të njoftoj ministrinë për çdo propozim ndryshim eventual të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimeve të projekteve dhe për këtë të kërkoj pëlqim nga ministria.

Gjatë testimit të pagesave për tre projekte të bashkëfinancimit me komuna, kemi identifikuar se kishte pasur ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, por pa rritur çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime të bëra menaxherët e projekteve të angazhuar nga komuna, nuk kishin njoftuar dhe marrë pëlqimet paraprakisht nga ministria.

Këto mangësi janë vërejtur tek projektet e poshtëshënuara:

- Ne lidhje me projektin "Bashkimi i qytetit – Projekti dy vjeçar" në Ferizaj në vlerë 4,030,290€, komuna kishte nënshkruar aneks për punë shtesë për 15 pozicione në vlerë 399,419.5€. Për këto ndryshime nuk ishte njoftuar ministria;
- Tek projekti "Zgjerimi dhe ri-konstruktimi i rrugës Prilep-Izniq" në vlerë 422,002€, kishte ndryshime të sasive të realizuara në 12 pozicione të kontratës në vlerë 15,957€. Pavarësisht së vlera totale e kontratës nuk kishte ndryshuar, pozicione të caktuara ishin rritur deri në 30% më shumë nga sasia e kontraktuar; dhe
- Tek projekti "Asfaltimi i rrugëve në Deçan" kontrata në vlerë 3,179,117€, kishte ndryshime të sasive të realizuara në 6 pozicione të kontratës në vlerë 163,132€. Pavarësisht së vlera totale e

kontratës nuk kishte ndryshuar, pozicione të caktuara ishin rritur deri në 18% më shumë nga sasia e kontraktuar.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e mos-planifikimit të mirëfilltë të projekteve dhe mos funksionimit të kontrolleve të duhura lidhur me mbikëqyrjen e këtyre projekteve.

Ndikimi

Ndryshimi i paramasës së projektuar dhe të kontraktuar në mungesë të aprovimeve të duhura rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë në pajtim me kërkesat e projektit dhe mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar. Gabimet e bëra nga organi mbikëqyrës me rastin e përllogaritjes së punimeve të kryera ndikojnë në pagesa të pa rregullta.

Rekomandimi B6

Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të kërkohen pëlqimet paraprake dhe aprovimet përkatëse në përputhje me rregullat e aplikueshme si dhe të sigurohet se pagesa bëhet vetëm për sasitë e realizuara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B7 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja

Neni 39.1 i LMFPP nr.03/L-048, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagesë.

Në 14 raste pagesat në vlerë 1,902,198€, ishin realizuar pas afatit kohorë ligjorë prej 30 ditësh. Vonesat variojnë nga një deri në shtatë muaj.

Shkak për vonesat në pagesa ishte mungesa e mjeteve financiare, pasi që për disa nga këto projekte në vitet e mëparshme ishin lidhur kontrata pa fonde të mjaftueshme.

Ndikimi

Vonesat në realizimin e pagesave rrisin rrezikun që planet e shpenzimeve aktuale të mos realizohen për shkak që ministria duhet t'i shlyejë obligimet e vitit paraprak dhe gjithashtu rrit rrezikun që në periudhat e ardhshme ministria të ballafaqohet me konteste gjyqësore apo veprime përmbarimore të cilat mund të rezultojnë me obligime shtesë për ministrinë.

Rekomandimi B7

Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt ka fonde të mjaftueshme të planifikuara, në mënyrë që kjo të mos reflektohet në kryerjen e obligimeve ndaj OE. Njëkohësisht të rishikoj mekanizmat e kontrollit në sistemin e menaxhimit të faturave, ashtu që të gjitha pagesat e të bëhen në përputhje me afatet kohore ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja C1 - Përdorimi i kontratave jo adekuate, vlera të paqarta dhe tejkalim i pagesave për kontratat publike dhe ato kornizë

Gjetja

Neni 9 i LPP-së përcakton se "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar". Gjithashtu neni 56.11 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP) parasheh që "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasitë indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët. Në këto raste nuk vlen pragu apo tavani plus/minus tridhjetë përqind (30%)".

Për projektin "Mirëmbajta Verore dhe Dimërore e Rrugëve Nacionale dhe Regjionale të Kosovës", të iniciuar në vitet paraprake ishte aplikuar dosja e tenderit për kontratën publike kornizë. Vlera e parashikuar për tri vite për 14 llote në dosje të tenderit por edhe në deklaratë të nevojave ishte 17,231,050€. Edhe pse ishte përcaktuar sasia indikative nga njësia kërkuese, kontratat ishin nënshkruar për çmim njësi pa përcaktuar peshën në bazë të rëndësisë së secilës kategori të shërbimeve ose secilit artikull. Testimi i mostrave tona për 6 kontrata (6 llote), ka vënë në dukje se vlera e realizuar për këto kontrata ishte më e lartë se vlera e parashikuar për 3,327,204€.

Përveç këtyre projekteve dukuri e njëjtë e lidhjes së kontratës ishte hasur edhe tek tri pagesa të testuara për projektin "Mirëmbajtja e Urave për rrugët nacionale dhe regjionale të Kosovës" si dhe të dy pagesave tek projekti "Sinjalizimi dhe Mirëmbajtja e pajisjeve në rrugët Nacionale dhe Rajonale te Republikës se Kosovës".

Lidhur me këtë çështje është rekomanduar edhe vitin paraprak. Ndërsa kemi vërejtur se lidhur me këtë çështje ministria ka filluar të marr masa duke evituar paqartësitë e cekura, duke aplikuar procedurat e duhura të prokurimit.

Si shkak i tejkalimit ishte përdorimi i kontratave jo adekuate me vlera të paqarta, përkatësisht hartimi i gabuar i kontratave me çmimin për njësi.

Ndikimi

Nënshkrimi i kontratave të paqarta sa i përket çmimit dhe sasive, e vështirësojnë menaxhimin e tyre dhe mund të shpien në tejkalimin e tyre përtej planifikimit.

Rekomandimi C1

Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura për të siguruar që përmes menaxherëve të kontratave do të bëhet mbikëqyrja e duhur e realizimit të kontratave në mënyrë që të mos bëhet tejkalimi i tyre. Gjithashtu, ministri duhet të siguroj përmes zyrës së prokurimit se aplikohen lloji i procedurës për kontratë kornizë duke potencuar devijimin +/-30% në vlerën indikativë të kontratës (në rastet kur mund të definohet sasia

indikative), dhe vetëm në rastet kur sasia indikative nuk mund të definohet, atëherë të aplikohen kontrata me çmim njësi në formën që e parasheh ligji.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë komunalitë) në vitin 2021 ishte 17,139,662€, prej tyre ishin shpenzuar 15,181,017€ apo rreth 89%. Këto shpenzime kanë të bëjnë kryesisht me mirëmbajtje të auto rrugëve, shpenzime kontraktuese tjera, qiraja për ndërtesa, mirëmbajtje të teknologjisë informative, furnizim për zyre etj.

Çështja A6 - Paqartësi në vendosjen e kritereve në dosjen e tenderit

Gjetja

Neni 19.2 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për prokurim thekson "Kurdo që AK ndan aktivitetin në Lote, AK duhet të përcaktoj, në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosje të Tenderit, nëse OE do të shpërblehen për: a) të gjitha Lotet; apo b) një numër të caktuar të Loteve. Kurdo që AK përzgjedh opsionin (b), AK duhet të përcaktoj në Njoftimin për Kontrate dhe në Dosje të Tenderit numrin maksimal të Loteve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues.

Në procedurën e prokurimit "Mirëmbajtja verore dhe mirëmbajtja dimërore 2021/2022 e rrugëve nacionale dhe rajonale", e ndarë në 14 lote për regjione të ndryshme kemi vërejtur që kishte mangësi në vendosjen e kritereve në dosjen e tenderit.

Ministria ka përcaktuar në Dosjen e tenderit (DT) se tenderuesit mund të aplikojnë në të gjitha pjesët por numri maksimal i pjesëve që do të mund të shpërblehen tek një tenderues është 1 (Një), ndërsa në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe profesionale në DT tek dëshmitë e kërkuara ishte specifikuar se nëse OE aplikon në më shumë se dy pjesë (llot) atëherë duhet të ofrohet stafi edhe për aq lote sa konkurron tenderuesi. Këto dy kërkesa janë në kundërshtim me njëra tjetrën dhe shkaktojnë paqartësi tek OE.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit.

Ndikimi

Vendosja e kritereve të tilla mund të ketë ndikim në kufizimin e pranimit të ofertave më të volitshme për llote të ndryshme dhe mos-arritjen e vlerës për para.

Rekomandimi A6

Ministri në bashkëpunim me menaxherin e prokurimit duhet të sigurojnë që kriteret e vendosura në Dosjen e tenderit të jenë të qarta, po ashtu të sigurojnë se dëshmitë e kërkuara të mos bien në kundërshtim me kriteret e vendosura në DT.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B8 - Realizimi i shpenzimeve të telefonisë në mungesë të kontratës valide

Gjetja

Rregulla Financiare 01/2013 e MF-së për Shpenzim të Parasë Publike, neni 26, obligon të gjitha autoritetet publike, organizatat buxhetore dhe ndërmarrjet publike, se asnjë detyrim që është rezultat i një dokumenti, marrëveshje apo aranzhimi nuk zbatohet nëse dokumenti, marrëveshja ose aranzhimi i këtillë që themelon apo rezulton në lindjen e këtij detyrimi është përpiluar, pranuar apo lidhur në një mënyrë që nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në dispozitat e ligjit LMFPP.

Ministria në vitin 2021 kishte pranuar dhe paguar shërbimet e telefonisë mobile, fikse dhe shpenzime postare në mungesë të një kontrate. Ministria nuk kishte lidhur ndonjë marrëveshje për këto shërbime. Vlera totale e këtyre pagesave për vitin 2021 ishte 74,242€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos lidhjes së kontratës së re nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB).

Ndikimi

Pranimet e shërbimeve pa mbështetje në dokumente ligjore siç është kontrata, mund të shkaktojnë pranim të shërbimeve të pafavorshme dhe jo në përputhje me çmimet e tregut.

Rekomandimi B8

Ministri në bashkëpunim me MPB-në duhet të gjej një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 190,072,625€, prej tyre ishin shpenzuar 123,665,991€ apo 65%. Ato kanë të bëjnë me ndërtime të rrugëve, shtresime të rrugëve, bashkëfinancime të projekteve bazuar në Memorandumet me komunat, mirëmbajtje e rrugëve, pagesat për shpronësimet e tokave, rregullimet e lumenjve etj.

Çështja B9 - Pranimi teknik i projekteve nga komisionet me përbërje jo kompetente

Gjetja

Sipas Udhëzimit Administrativ Nr.2008/3 neni 2 pika 3 e thekson se ‘Anëtarët e komisionit të ekspertëve për mbikëqyrje të punëve, pranim teknik dhe kolaudimin e punëve të kryera duhet të jenë persona me kualifikim dhe njohuri të specializuara në sektorin e infrastrukturës rrugore nga lëmi i ndërtimtarisë, sigurisë në komunikacionin rrugor, e të ngjashëm’.

Për projektet ‘’Asfaltimi i rrugëve në Kamenicë’”, “Mbikalimi në Polluzhë dhe Tërstenik, “Ndërtimi i rreth rrotullimit në Rrugën Nacionale në Banullkë” dhe “Ndërtimi i rrugës te varrezat në Pejë” kemi identifikuar se përbërja e komisioneve për pranimin e punëve nuk ishte në përbërje nga anëtarët me

kompetencë dhe njohuritë nga fusha e kërkuar. Pranimi teknik dhe vlerësimi i gjendjes së ndërtimit, ishte bërë nga komisionet në përbërje të një inxhinieri dhe anëtarët tjera si ekonomist, jurist, inxhinier elektroteknikës, si dhe zyrtar nga zyra e prokurimit.

Sipas ministrisë kjo kishte ndodhur për shkak të numrit të pamjaftueshëm të inxhinierëve.

Ndikimi

Pranimi teknik dhe vlerësimi i gjendjes së ndërtimit nga zyrtarë jo kompetent, rritë rrezikun e pranimit të projekteve jo në pajtueshmëri me standardet dhe cilësinë e kërkuar. Po ashtu, kjo nuk është në pajtim me parimet e ndarjes së detyrave.

Rekomandimi B9

Ministri duhet të siguroj se pjesë e komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar në pajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B10 - Vonesa në realizimin e projekteve

Gjetja

Në kontratat e nënshkruara ndërmjet ministrisë dhe operatorëve ekonomik përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve.

Në shtatë raste, kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë. Rastet e identifikuara janë:

- Projeki “Zgjerimi i Rrugës Nacionale N9.1 segmenti Dollc Gjakovë, pjesa 1, kontrata në vlerë 5,076,875€, ishte nënshkruar me dt. 11.03.2019, në kohëzgjatje tri vite .Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2021 ishte 1,690,375€ ose 29% e vlerës së kontraktuar; Projekti “Dollc Gjakovë” pjesa 3, kontrata e nënshkruar me dt. 09.07.2019 në vlerë 5,343,111€, në kohëzgjatje tri vite . Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2021 ishte 1,848,842€ apo 33% e vlerës së kontraktuar.
- Projekti “Ndërtimi i Autoudhës : Prishtinë – Gjilan – Dheu i Bardhë, Segmenti: Banullë – Bresalc lloti 4 ‘’, kontrata në vlerë 9,567,861€, ishte nënshkruar me datë 13.02.2018, në kohëzgjatje tri vite. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2021 ishte 6,535,065€ apo 68% e vlerës së kontraktuar.
- Projekti ”Ndërtimi i Rrugës Prishtinë-Mitrovice”, kontrata në vlerë 26,732,809€, ishte nënshkruar me datë 20.12.2019 në kohëzgjatje tri vite. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2021 ishte 5,346,562 apo 20 % e vlerës së kontraktuar.
- Projekti “ Zgjerimi i Rrugës Hyrja në Qytetin e Prizrenit” kontrata në vlerë 3,852,100€, ishte nënshkruar me date 10.12.2019, në kohëzgjatje tri vite. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2021 ishte 1,926,050€ apo 50% e vlerës së kontraktuar.
- Projekti “Bashkimi i qytetit – Projekti dy vjeçar” në Ferizaj, kontrata në vlerë 4,429,710€, ishte nënshkruar nga komuna me datë 17.09.2018 në kohëzgjatje dy vite. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2021 ishte 4,313,652€ apo 97.38 % e vlerës së

kontraktuar.

- Projekti " Rikonstruimi i rrugës Varosh – Gerlice", bashkëfinancim me Komunën e Ferizajt, kontrata në vlerë 2,919,290€, ishte nënshkruar me datë 22.06.2018, në kohëzgjatje tri vite. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2021 ishte 1,657,074€ apo 57% e vlerës së kontraktuar.
- Projekti "Unaza e jashtme në Ferizaj" bashkëfinancim me Komunën e Ferizajt, kontrata në vlerë 2,865,167€,ishte nënshkruar me datën 15.11.2016, në kohëzgjatje tri vite. Punimet kishin filluar me datën 17.11.2016 dhe kishin përfunduar me datën 01.12.2021.

Sipas ministrisë, problemet me shpronësimin e tokave, elaborati i pakompletuar i shpronësimit, gabimet në projektin ekzekutiv dhe mungesa e mjeteve buxhetore ishin si shkak i mos realizimit të projekteve sipas afateve të përcaktuara në kontrata.

Ndikimi Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që ministria të mos arrijë objektivat e përcaktuara, vështirësi në qarkullimin e qytetarëve në rrugët e caktuara dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

Rekomandimi B10 Ministri duhet të siguroj se para inicimit të projekteve paraprakisht kryhet procesi i shpronësimit të tokave në të cilat parashihet realizimi i projekteve si dhe ti kushtohet rëndësi përpilimit/përgatitjes të projekteve ekzekutive në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B11 - Mangësi në hartimin e projekteve ekzekutive për ndërtim të rrugëve

Gjetja Neni 8.4 i rreg. nr. 02/2013 – për Menaxhimin e pasurisë jofinanciare në OB përcakton që: Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në pajtim me kontratën apo urdhër blerjen. Sipas kontratave projektuesi duhet të hartojë projektin ideor dhe kryesor me elaboratet dhe projektet përcjellëse, ku projektuesi duhet të ketë konsideratë për kryqëzimet e largpërçuesve, rrjetin e telefonisë, të ujësjellësit dhe instalimet tjera etj.

Nga mostrat e testuara në dy raste kemi vërejtur se ishte paraqitur nevoja për ndryshime dhe punë shtesë si rezultat i hartimit të dobët të projekteve. Këto defekte në projekt nuk ishin identifikuar gjatë fazës së përpilimit të projektit si dhe gjatë fazës së kontrollit dhe pranimit të projektit nga ministria. Rastet e identifikuara janë:

- Projekti "Ndërtimi i Autoudhës A7.1- Kryçzimi me disnivel A6 A7.1 (Banullë) - Dheu i Bardhë - pjesa Kryqëzimi në disnivel L=22.31 km, Lot 4, në vlerë 8,700,127€, kontrata e nënshkruar me datë 13.02.2018, - aneks kontrata në vlerë 867,733€ e nënshkruar me datë 18.11.2021.
- Projekti "Zgjerimi i Rrugës Nacionale 9.1, Segmenti Dollc - Gjakovë L = 31.00 km, Lot 1" në vlerë 8,590,949€ e nënshkruar me datë

09.07.2019, aneks kontrata në vlerë 821,655€, e nënshkruar me datë 20.12.2021.

Kompania projektuese kishte pranuar gabimet/devijimet në projekt, mirëpo nuk kishte marrë ndonjë veprim shtesë në lidhje me verifikimin dhe përcaktimin e punëve shtesë, duke ja lënë përgjegjësinë menaxherit të projektit.

Kjo ka ndodhur pasi që kompania projektuese kishte dorëzuar projektet duke mos përfillur kërkesat e përgjithshme të parametrave Teknik të kontratës, po ashtu komisioni i pranimit nuk ishte siguruar se projektet përmbushin të gjitha kushtet për pranim.

Vlen të theksohet, sipas të dhënave të raportuara nga Ministria, në vitin 2021 ishin nënshkruar gjithsej 30 aneks kontrata, për punë shtesë me procedurë të negociuar në vlerë totale 6,513,491€. Kjo ishte rezultat i mangësive të identifikuara gjatë realizimit të projekteve ku gjendja në terren nuk përkonte me projektet ekzekutive.

Ndikimi

Hartimi i projekteve jo në pajtueshmëri me kërkesat teknike, rezulton me mos ndërtimin e rrugëve në afatet e parapara me kontratë, pamundëson planifikimin e vlerës reale të investimeve, rrit nevojën e kërkesave për punë shtesë që në fazën e inicimit të punimeve duke shkaktuar kosto dhe procedura shtesë për përfundimin e projekteve. Po ashtu, punët shtesë ndikojnë në planifikimin dhe menaxhimin e projekteve kapitale duke krijuar kosto shtesë të projekteve aktuale dhe rrezikojnë fondet e ndara për projekte tjera duke pamundësuar financimin e projekteve të reja.

Rekomandimi B11

Ministri duhet të siguroj që para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë: matjet gjeodezike, incizimin e gjendjes reale në terren, zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe përcaktimin e saktë të trashësisë së rrugëve. Në rastet e gabimeve me implikim financiar për MMPHI-në, jo vetëm të kërkohet korrigjimi i tyre por edhe të aplikohen penalizime tek kompania projektuese.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A7 - Mos funksionalizimi i "Sistemit Elektronik të Shpronësimit"

Gjetja

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 03/78 të datës 09.03.2016 obligohen të gjitha institucionet Shtetërore dhe Publike, të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi, për përdorimin e Sistemit Elektronik të Shpronësimit (SESH) të krijuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, duke futur të dhënat e punës së tyre gjatë procesit të shpronësimit, vlerësimit, kompensimit dhe regjistrimit të pronave të paluajtshme. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Financave, institucionet tjera shtetërore dhe publike të cilat janë të përfshira në procesin e shpronësimit, të përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205.

Për ta menaxhuar më lehtë çështjen e shpronësimeve, MMPH-ja është në proces e sipër të vendosjes së (SESH) që nga viti 2013, mirëpo ky sistem ende nuk është funksionalizuar dhe regjistrimi i të dhënave të shpronësimit vazhdon të kryhet në mënyrë manuale në programin Excel. Data-baza ku ruhen të dhënat e pagesave të ekzekutuara ndër vite për shpronësimet, mbahet në formatin Excel, gjë që paraqet rrezik të lartë që shënimet të humbasin ndryshohen apo të manipulohen, duke mos lënë gjurmë. Lidhur me këtë çështje është rekomanduar edhe në raportin e auditimit të vitit paraprak (për ish MEA) por sistemi ende nuk ishte funksional.

Sipas zyrtarëve përgjegjës të Ministrisë në këtë proces janë të involvuar edhe institucione tjera shtetërore dhe kërkohet bashkëpunim ndërinstitucional për tu funksionalizuar sistemi. Po ashtu për shkak të kompleksitetit të sistemit kërkohet edhe sigurim i kapaciteteve njerëzore, profesionale e teknike.

Ndikimi

Mos funksionalizimi i SESh-it dhe regjistrimi i të dhënave të shpronësimit vetëm në Excel, si dhe mungesa e një procedure për të funksionalizuar plotësisht këtë proces, rrit rrezikun e gabimeve dhe cenon sigurinë e të dhënave.

Rekomandimi A7

Ministri në bashkëpunim me institucionet e involvuara në këtë proces duhet të rishikoj tërë procesin dhe t'i identifikoj të gjithë faktorët që kanë shkaktuar vonesat në funksionalizimin e këtij sistemi, si dhe të siguroj se brenda një periudhe të arsyeshme, sistemi të jetë në përdorim nga të gjitha institucionet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A8 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore

Gjetja

Neni 39.1 i LMFPP nr.03/L-048, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagesë. Po ashtu, edhe neni 40.1 thekson "Kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë".

Përmes vendimeve gjyqësore në kategorinë e investimeve kapitale në vitin 2021 ishin ekzekutuar pagesa në vlerë 7,356,606€. Këto pagesa në përgjithësi kanë të bëjnë me pagesën e shpronësimeve përmes vendimeve gjyqësore si rezultat i ankesave nga palët e pakënaqura me vendimin përfundimtar të shpronësimit. Në tri (3) raste të testuara të këtyre pagesave në vlerë 709,300€, Ministria kishte paguar 12,383€ shpenzime shtesë për procedura të përmbarimit.

Kjo dukuri kryesisht ka ndodhur për shkak të mungesës së buxhetit për kompensimin e të gjitha kërkesave të paraqitura nga palët të cilët më pas i janë drejtuar procedurës përmbarimore për ekzekutim të vendimit gjyqësor.

Ndikimi Mos pagesa me kohë e obligimeve ka ndikuar që pagesat të realizohen direkt nga Thesari. Kjo situatë ka rezultuar me rritjen e kostos së ministrisë duke krijuar vështirësi në realizimin e projekteve të aprovuara për vitin përkatës/vijues.

Rekomandimi A8 Ministri duhet të merr masa që të evitohen kontestet përmbarimore që lidhen me shpronësimet si dhe të sigurojë buxhet të mjaftueshëm që obligimet të paguhen brenda afateve ligjore në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i i ministrisë me kosto shtesë të përmbarimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A9 - Pagesat për shpronësime

Gjetja Neni 16.2 i Ligjit nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme përcakton "Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtruesi i kërkesës ose Përfituesi i pritur – nëse ka të këtillë – që t'ua paguajë shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, Pronarit të prekur ose Zotëruesit të Interesit. Kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë: 2.1. shuma e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus; 2.2. interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimin Përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore.

Në katër (4) raste të testuara, pagesat për shpronësime në vlerë 1,794,905€ ishin bërë 24-30 muaj pas aplikimit nga përfituesi dhe Ministria nuk kishte aplikuar interesin në shkallë prej 7% ashtu siç parashihet me ligj.

Sipas zyrtarëve të ministrisë kjo ka ndodhur për shkak të paqartësive ligjore lidhur me këtë çështje.

Ndikimi Mos-aplikimi i interesit në pagesat e shpronësimit është në kundërshtim me ligjin dhe dëmton përfituesit e pritur respektivisht pronarët e tokave të shpronësuara.

Rekomandimi A9 Ministri duhet të siguroj buxhet të mjaftueshëm për kryerjen e obligimeve financiare të shpronësimeve si dhe të siguroj që kompensimi të bëhet në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm. Më tutje, ministri të formojë një komision i cili do të analizojë bazën ligjore sa i përket pagesave dhe interesit të thjeshtë vjetor në lidhje me shpronësimet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,871,018,488€, pasurive jokapitale është 1,228,444€ si dhe e stoqeve 152,493€.

Çështja C2 - Mos finalizimi në kohë i procesit të inventarizimit të pasurive

Gjetja

Sipas rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare, neni 19 paragrafi 4 pika 7 “Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të Komisionit për Inventarizimin e Pasurisë jo Financiare duhet të bëhet në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore”.

Komisioni për inventarizimin e pasurisë jo financiare kishte hartuar raportin mbi inventarizimin e pasurive me datën 28.02.2022, përderisa vendimi për caktimin e këtij komisioni ishte nxjerrë me datë 22.12.2021. Ky proces ishte kryer me vonesë duke pas parasysh se raporti ishte hartuar pas dorëzimit të PFV-ve.

Vonesa në procesin e inventarizimit të pasurisë ka ndodhur në mungesë të kontrolleve të mjaftueshme për të realizuar këtë proces brenda afateve të parapara kohore.

Ndikimi

Mos finalizimi në kohë i procesit të inventarizimit të pasurive ndikon që korrigjimet e nevojshme për diferencat nga krahasimi i raportit të inventarizimit me regjistrin e pasurisë të mos bëhen me kohë para përgatitjes së PFV ku si rrjedhojë prezantimi i pasurisë mund të mos jetë i saktë.

Rekomandimi C2

Ministri duhet të siguroj se procesi i inventarizimit përpilohet me kohë dhe është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare në mënyrë që të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive në PFV.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

MMPHI në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,160,486€. Kjo vlerë përbehet nga obligimet e pa-arkëtuara të kompanive shfrytëzuese të ujit, faturime për pompa të karburanteve, transport të jashtëzakonshëm, hyrje-daljet e objekteve afariste etj.

Çështja A10 - Mos marrja e veprimeve ndaj shfrytëzueseve të ujit pa leje ujore

Gjetja

Ligji nr. 04/L-147 Për Ujërat e Kosovës neni 97, parasheh në hollësi veprimet dhe kompetencat që duhet të ndërmarrë Inspektorit i ujërave në rastet kur identifikon kryerje të aktiviteteve pa leje ujore apo në kundërshtim me lejen. Kur konstatohet se janë shkelur dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e nxjerra në bazë të këtij Ligji, inspektori i ujërave i raporton Ministrisë me shkrim për parregullsitë dhe mungesat, ndërsa me aktvendim do t'i caktojë masat dhe afatet për eliminimin e tyre.

Nga regjistri i pranuar prej ministrisë për gjendjen deri në fund të vitit 2021 për shfrytëzuesit e ujit, janë raportuar rreth 40 kompani shfrytëzuese të ujit, të cilëve ju ka skaduar leja ujore dhe sipas ministrisë nuk iu ka vazhduar më për shkak të mos shlyerjes së borxheve të akumuluara. Sipas ministrisë këta shfrytëzues vazhdojnë të shfrytëzojnë ujin pa leje ujore dhe pa e kryer obligimin financiar. Inspektorati i ujërave as gjatë vitit 2021 nuk kishte ndërmarrë veprime konkrete për ndërprerjen e aktiviteteve të tyre në bazë të kompetencave që i takojnë edhe pse kjo çështje është ngritur edhe në raportet e auditimit të viteve paraprake.

Kjo ka ndodhur në mungesë të ndërmarrjes së veprimeve nga Ministria për evitim të kësaj dukurie dhe për shkak të pa-qartësisë së vendimeve të Qeverisë për faljen dhe lehtësimin e borxheve në rastin e Operatorëve Ekonomik që ambalazhojnë ujin.

Ndikimi

Mungesa e veprimeve të nevojshme për parandalimin dhe rregullimin e dukurive të tilla ndikon në shfrytëzimin e pa kontrolluar të ujit, në nënvlerësimin e llogarive të arkëtueshme dhe të hyrave, si dhe në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.

Rekomandimi A10

Ministri të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet kur shfrytëzuesit e ujërave operojnë pa leje ujore apo me leje të skaduar, të merren masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B12 - Mos ndërmarja e veprimeve për inkasim të borxheve

Gjetja

Neni 4 i Udhëzimit Administrativ 1/2014 mbi Caktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale përcakton se "Tarifat për shfrytëzimin e tokës për vendosjen e instalimeve dhe kyçjeve në rrugët nacionale dhe rajonale, shfrytëzimin e tokës e cila jepet me qira dhe vendosje të objekteve të përkohshme, bëhet sipas tarifave të përcaktuara". Më tutje neni 6 - Dispozitat kalimtare parasheh që me hyrjen

në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ Ministria do ti modifikoj të gjitha kontratat për shfrytëzimin e tokës të cilat i takojnë rrugëve Nacionale dhe Rajonale brenda afatit prej gjashtë (6) muaj.

Po ashtu, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me shfrytëzuesit e pronave publike përcaktohen afatet e inkasimit të të arkëtueshmeve.

Në dy mostra të testuara në vlerë 108,742€ kemi identifikuar që Ministria kishte faturuar kontraktuesit ndër vite por nuk kishte arkëtuar asnjë borxh. Për më tepër me hyrjen në fuqi të UA 1/2014 në vitin 2014, Ministria kishte faturuar kontraktuesit me tarifat e reja por nuk kishte ndërmarrë masa për t'i modifikuar kontratat e tyre sipas afatit ligjor të përcaktuar në udhëzuesin e ri administrativ. Në njërin rast të testuar kontrata me kontraktuesin ishte nënshkruar në vitin 2000 dhe borxhi i pa-arkëtuar nga viti 2001 ishte 83,206€ ndërsa në rastin tjetër kontrata i takonte vitit 2007 ndërsa borxhi i pa-arkëtuar nga viti 2010 ishte 25,536€.

Sipas zyrtarëve të ministrisë dhe dokumenteve të ofruara, Ministria kishte tentuar në disa raste t'i arkëtoj borxhet përmes procedurave përmbarimore por si rezultat i kontratave të vjetërsuara të cilat nuk përmbajnë të dhëna bazike mbi kontraktuesit nuk është arritur të arkëtohet borxhi.

Ndikimi Mos ndërmarrja e masave konkrete për arkëtimin e borxheve, mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të buxhetit për shkak të mos realizimit të të hyrave.

Rekomandimi B12 Ministri duhet të sigurojë ripërtëritjen e kontratave me shfrytëzuesit e pronave publike në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe të krijojë mekanizma efektiv për arkëtimin e borxheve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i Auditimit të brendshëm është i themeluar me Statutin e Njësisë së Auditimit. Si rezultat i ndryshimeve strukturore të ministrisë dhe në mungesë të rregullores së re për organizim të brendshëm në MMPHI funksionojnë ndaras dy NJAB (ajo e ish MI dhe ish MMPH). Komiteti i Auditimit ishte thememluar pas fuzionimit të dy ministrive po i njëjti nuk kishte qenë funksional.

Çështja B13 - Komiteti i auditimit jo funksional

Gjetja

Në dispozitat e UA MF-NR. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik, Neni 5.1 definon se 'Komiteti i Auditimit ndihmon udhëheqësin e subjektit të sektorit publik në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike, me qëllim që të arrihen objektivat e synuara të organizatës'. Po ashtu, paragrafi 2 i këtij neni thekson se 'Komiteti i Auditimit mbështet Njësinë e Auditimit të Brendshëm për të siguruar pavarësinë nga ndërhyrjet e menaxherëve, operacionet e të cilëve auditohen dhe për të siguruar që rekomandimet e auditorit janë trajtuar si duhet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik'.

MMPHI kishte themeluar Komitetin e Auditimit në qershor të vitit 2021, por ky komitet nuk kishte qenë funksional dhe nuk kishte mbajtur asnjë takim siç kërkohet me udhëzimin administrativ.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos bashkëpunimit ndërmjet Komitetit të auditimit dhe NJAB-ve.

Ndikimi

Një situatë e tillë zbeh ndikimin e proceseve të kontrollit të brendshëm që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe vlerësimin e rrezikut, si dhe pamundëson mbikëqyrjen e punës së auditimit të brendshëm dhe marrëdhënies së tij me menaxhmentin në drejtim të përmirësimit të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi B13

Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja NjAB dhe të sigurohet pavarësia e kësaj njësie.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[6]	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**221,695,294**	**212,275,042**	**143,815,760**	**92,170,794**	**196,989,432**
Grante Qeveritare – Buxheti	97,645,294	145,459,497	137,304,739	63,943,147	124,357,256
Financimi përmes huamarrjes	10,800,000	11,200,000	3,107,767	6,424,933	9,985,700
Financimi përmes huamarrjes – klauzola e investimeve	101,250,000	55,130,000	3,401,670	5,281,877	0
Te hyrat nga AKP-ja	12,000,000	0	0	16,520,837	62,646,477
Donacionet vendore	0	3	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	485,542	1,583	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 9,420,252€. Ky ndryshim fillimisht ka ardhur me rishikim të buxhetit si rezultat i ndryshimit strukturor të ministrisë, ku MMPHI në fillim të vitit kishte funksionuar si Ministri e infrastrukturës. Ndryshimet tjera të buxhetit janë rezultat i ndarjeve të reja dhe shkurtimeve buxhetore me vendime qeveritare.

Në vitin 2021 MMPHI kishte shpenzuar 143,815,760€ apo 68% të buxhetit final. Në këtë përqindje jo të kënaqshme të realizimit ka ndikuar shpenzimi i ulët i fondeve të ndara nga Huamarrja dhe Klauzola e Investimeve ku në vitin 2021 nga 11,200,000€ mjete të planifikuara nga Huamarrja ishin shpenzuar vetëm 3,107,767€ apo 28%, ndërsa nga 55,130,000€ të planifikuara nga Klauzola e Investimeve ishin realizuar vetëm 3,401,670€ apo 6%. Pra zbatimi i buxhetit në përgjithësi mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe shpenzimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Vlen të theksohet se të dhënat për shpenzimet e viteve paraprake kanë të bëjnë me ish "Ministrinë e Infrastrukturës" prandaj nuk mund të bëhet një analizë e krahasueshme.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**221,695,294**	**212,275,042**	**143,815,760**	**92,170,794**	**196,989,432**
Pagat dhe mëditjet	2,137,047	3,687,754	3,685,246	1,805,502	1,812,208

Mallrat dhe shërbimet	12,982,243	16,885,026	14,961,967	11,488,445	8,371,109
Komunalitë	240,190	254,636	219,050	158,304	145,970
Subvencionet dhe transferet	1,593,814	1,375,000	1,283,507	1,300,800	1,502,676
Investimet Kapitale	204,742,000	190,072,625	123,665,991	77,417,743	185,157,470

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë.


Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,550,707€ dhe kjo rritje ishte rezultat i rishikimit buxhetor pas ndryshimit strukturor të ministrisë në vlerë prej 1,973,514€, reduktim i fondeve si rezultat i vendimeve qeveritare në vlerë 426,896€ dhe ndarje nga fondet e përcaktuara të donatorëve në vlerë 4,092€. Realizimi i buxhetit final ishte 100%

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,917,230€. Kjo rritje ishte rezultat i rishikimit të buxhetit në vlerë 2,395,815€ pas ndryshimeve strukturore të ministrisë, vendimeve të Qeverisë për ndarje në vlerë 1,911,535€ dhe reduktime të fondeve në vlerë 871,574€ si dhe ndarje e mjeteve nga fondet e donatorëve 481,454€. Realizimi i buxhetit final ishte 89%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 218,814€. Ky ndryshim fillimisht ka ardhur me rishikim buxhetor ku ishin shtuar mjete në vlerë 200,000€ si rezultat i ndryshimit strukturor të ministrisë dhe më pas kishte reduktime të fondeve në vlerë 418,814€ si rezultat i vendimeve të qeverisë për kursime. Realizimi i buxhetit final ishte 93%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 14,669,375€. Ky ndryshim fillimisht kishte ndodhur me rishikim buxhetor ku si rezultat i fuzionimit të Ministrive ishin shtuar mjete në vlerë 20,029,372€. Po ashtu vlen të theksohet që me rishikim buxhetor kishte reduktim të mjeteve të planifikuara me klauzolë të investimeve në vlerë 46,120,000€. Ndryshimet tjera buxhetore në këtë kategori ishin rezultat i vendimeve qeveritare për ndarje në vlerë 27,002,593€ dhe reduktime të mjeteve në emër të kursimeve në vlerë 15,581,340€. Në këtë kategori buxheti ishte realizuar vetëm 65%. Arsyet e këtij niveli jo të kënaqshëm të shpenzimit kishin të bënin me shtyrjen dhe mos-realizimin e projekteve të financuara nga burimet e Huamarrjes dhe Klauzolës së investimeve.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga MMPHI në vitin 2021 ishin në vlerë 6,107,582€. Të hyrat jo tatimore kryesisht kanë të bëjnë me të hyra të realizuara nga taksat e lejeve të vozitjes, licencat për transport të mallrave, të hyrat nga shfrytëzimi i ujit, licencat për shfrytëzimin e pyjeve, licenca tjera për afarizëm etj, ndërsa të hyrat tjera kanë të bëjnë me të hyrat nga kthimi i mjeteve nga vitet e mëhershme.

Për shkak të ndryshimeve strukturore të ministrisë në vitin 2021, analiza e realizimit në raport me planifikimin dhe analiza e realizimit të hyrave ndër vite nuk është e krahasueshme pasi që projeksioni i vitit dhe realizimi në vitet paraprake në tabelë përfshinë të dhëna vetëm për ish Ministrinë e Infrastrukturës.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	**3,418,905**	**3,330,465**	**6,107,582**	**2,952,109**	**3,555,557**
Të hyrat jo tatimore	3,418,905	3,330,465	5,929,546	2,952,109	3,514,990
Të hyrat tjera	0	0	178,036		40,567

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Ashtu siç është sqaruar tek “Çështjet tjera” kjo ministri ka pësuar ndryshime strukturore gjatë vitit 2021. Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të ish “Ministrisë së Infrastrukturës” (MI) ka rezultuar në 32 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t’i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, 13 rekomandime ishin zbatuar; 2 ishin në proces të zbatimit, 13 nuk ishin zbatuar si dhe 4 rekomandime nuk janë të aplikueshme më.

Sa i përket rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak për ish “Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit”, rekomandimet e përsëritura që janë relevante për MMPHI, janë hapur si çështje të reja në këtë raport. (Ref. A4, A7, A8 dhe A10)

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj se kontrollet në zyrën e financave janë plotësisht efektive në mënyrë që të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara.	Shpalosja e obligimeve nuk ishte e saktë as këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	Edhe këtë vit shpalosja e detyrimeve kontigjente nuk ishte e saktë.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për opinion	Ministri të forcoj mekanizmat e kontrollit të brendshëm për të siguruar regjistrimin	Ky rekomandim nuk është	Nuk ka filluar zbatimi

		e saktë dhe të plotë të të gjitha pasurive kapitale në pajtim me kërkesat ligjore. Në një periudhë sa me të shpejtë, duhet të plotësohet pozita e zyrtarit të pasurive dhe të bëhen korrigjimet e nevojshme.	zbatuar.	
4.	Baza për opinion	Ministri duhet te siguroj se me rastin e përgatitjes së RVF zbatohen procedurat adekuate të kontrollit të brendshëm duke verifikuar saktësinë dhe plotësinë e të dhënave për llogaritë e arkëtueshme.	Nuk kemi hasur rast të tillë këtë vit.	I zbatuar
5.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurohet që menaxhimi i pasurisë jo financiare bëhet në përputhje me Rregulloren 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare dhe të siguroj se të gjitha pasuritë e ministrisë janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive. Po ashtu, duhet të siguroj që vlera e stoqeve të prezantohet drejt në RVF.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
6.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që regjistrit të pasurive t'i bëhet një rishikim i detajuar në mënyrë që të eliminohen mangësitë të cilat janë prezente në fushën e pasurive.	Ky rekomandim nuk është zbatuar por është bashkuar me rekomandimin B3 për shkak të ndikimit të njejtë që e kanë.	Nuk është i aplikueshëm më
7.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që përmes komisioneve përkatëse të bëhet një rishikim i detajuar i regjistrit të pasurive (sidomos vlerave të regjistruara të shpenzimeve të mirëmbajtjes) në mënyrë që të korrigjohen mangësitë e identifikuara dhe të prezantohet saktë vlera e pasurive në RVF.	Ky rekomandim nuk është zbatuar por është bashkuar me një rekomandim tjetër për shkak të ndikimit të njejtë që e kanë, përkaterisht rekomandimi B2.	Nuk është i aplikueshëm më
8.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për komuna, të barten tek komunat përfituese duke i larguar nga regjistrat e ministrisë.	Mangësi të njejta janë identifikuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
9.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur kontrollet e duhura të cilat mundësojnë menaxhimin e pasurisë në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, të bëhet azhurnimi i regjistrit të pasurive duke larguar automjetet të cilat nuk janë pronë e ministrisë dhe duke regjistruar ato të cilat janë në pronësi të saj.	Ky rekomandim nuk është zbatuar por është bashkuar me rekomandimin B2 për shkak të ndikimit të njejtë që e kanë.	Nuk është i aplikueshëm më
10.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se janë duke funksionuar kontrollet në departamentin e prokurimit dhe kërkesat të cilat i drejtohen	Zyra e prokurimit për projektet për të cilat kishte	I zbatuar

		këtij departamenti nga zyrtarët e përfshirë në procese të ndryshime të prokurimit, të trajtohen me kujdes në mënyrë që të evitohen vonesat e paarsyeshme. Për më tepër, Ministri të sigurojë evitimin e ndryshimeve të shpeshta të stafit në këtë departament për shkak të ruajtjes së konsistencës dhe për të evituar bartjen e përgjegjësisë së gabimeve të ndodhura.	kërkesa për pune shtese, kishte zhvilluar procedurat e prokurimit për nënshkrim të ankes kontratave. Nuk kemi hasur në ndonjë raste që punët nuk ishin realizuar si shkak i mos nënshkrimit të aneks kontratave.	
11.	Baza për konkluzion	Ministri duhet sigurohet se gjatë përgatitjes së dosjeve nga zyra e prokurimit, të ofrohen të gjitha informatat relevante për procedurën e cila do të aplikohet. Gjithashtu, zyra e prokurimit duhet të aplikoj llojin e procedurës për kontratë kornizë duke potencuar devijimin +/-30% në vlerën indikative të kontratës (në rastet kur mund të definohet sasia indikative), dhe vetëm në rastet kur sasia indikative nuk mund të definohet, atëherë të aplikohen kontrata me çmim njësi në formën që e parasheh ligji. Përpilimi i kontratave duhet të bëhet në mënyrë të atillë që të mos krijojnë konfuzion lidhur me vlerën dhe sasitë që duhen realizuar. Përveç kësaj, të marrë të gjitha masat e nevojshme që përmes raporteve periodike nga menaxherët e kontratave të mënjanohen tejkalimet.	Ky rekomandim ishte në proces të zbatimit. Në kontratat e reja ishin evituar paqartësitë rreth vlerave të kontratave, megjithatë edhe këtë vit kishte pagesa me kontratat paraprake, rrjedhimisht tejkalim të vlerave të tyre.	Pjesërisht i zbatuar
12.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që, kërkesat e ndryshme të palëve të treta të trajtohen në kohë sipas rregullativës ligjore në mënyrë që vendimet përkatëse të mos kenë implikim negativ në projektet e ministrisë. Tutje, duhet të forcoj kontrollet e brendshme duke siguruar komunikim të mirëfilltë në mes të drejtorive kyçe dhe duke siguruar informim të saktë dhe në kohë të personave që janë përcaktuar në menaxhimin e projekteve të ministrisë. Ministri, duhet të sigurohet që rruga e dëmtuar të kthehet sa më shpejtë në gjendjen e mëparshme.	Ministria kishte marrë masa dhe projekti ishte finalizuar. Raste të ngjajshme nuk kemi identifikuar këtë vit.	I zbatuar
13.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurohet se projektet ekzekutive të hartohen në harmoni me gjendjen në terren. Inicimi i projekteve të bëhet vetëm pas plotësimit të kushteve për realizimin e procesit të shpronësimit. Gjithashtu, kur paraqitet nevoja për punë shtesë të bëhet një analizë e hollësishme e sasive të nevojshme dhe në rastet kur nevojat e autoritetit kontraktues nuk mund të plotësohen pa bërë ndryshime thelbësore të kontratës, atëherë duhet të	Rekomandimi nuk është zbatuar por është bashkuar me një rekomandim tjetër (B11) për shkak të natyrës së ngjashme.	Nuk është i aplikueshëm më

		aplikohet procedurë e hapur e prokurimit në harmoni me kërkesat ligjore të LPP-së.		
14.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të mundësoj realizimin e aktiviteteve të parapara me aktemërime për këta të punësuar bazuar në objektiva të qarta të përcaktuara paraprakisht nga ministria. Gjithashtu, duhet të bëhet monitorimi i tyre i vazhdueshëm, ashtu siç parashihet me aktet ligjore.	Gjendja në raport me vitin paraprak lidhur me këtë kategori të të punësuarve ishte e njejtë.	Nuk ka filluar zbatimi
15.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë se menaxherët e projekteve nuk i anashkalojnë kërkesat ligjore dhe se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit ZKA.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
16.	Baza për konkluzion	Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të lidhura nga komunat për projektet që bashkë financohen me ministrinë, të kërkohet pëlqimi paraprak nga ministria siç është e paraparë me memorandumet e mirëkuptimit.	Raste të ngjashme kemi identifikuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
17.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të sigurohet që kërkesat e tilla të palëve tjera të shqyrtohen në dakordim me rregullativën ligjore dhe realizimi i projekteve të bëhet vetëm pasi të aplikohen të gjitha procedurat e parapara me ligj.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
18.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të gjej një zgjidhje sa më të shpejtë për lidhjen e kontratës me njërin nga operatorët ekonomik të telekomunikimit në mënyrë që më tutje të realizohen shpenzimet e rregullta bazuar në një kontratë valide për këto lloje të shërbimeve.	Gjendja ishte e njejtë edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
19.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri duhet të siguroj llogaridhënie adekuate duke identifikuar rastet e angazhimit të personelit në NjZP pa aprovim paraprak nga huadhënësi. Po ashtu, të siguroj rishikimin e përbërjes së anëtarëve në NjZP, për të qenë në harmoni me kërkesat sipas marrëveshjeve të aprovuara nga huadhënësi dhe të parandalojnë angazhimet e tilla në të ardhmen.	Nuk ishin angazhuar zyrtarë të rinj si dhe kontratat paraprake me zyrtarët e angazhuar kishin skaduar dhe ishin ndërprerë pagesat.	I zbatuar
20.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Ministri të ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar mbylljen e avanceve të hapura. Po ashtu, të merren masa konkrete që në të ardhmen zyrtarët të cilët marrin avance për udhëtime zyrtare t'i mbyllin ato me kohë dhe në përputhje me kërkesat e UA.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
21.	Investimet	Ministri duhet të siguroj se pjesë e	Edhe këtë vit	Nuk ka filluar zbatimi

	kapitale	komisioneve për pranimin e projekteve dhe punëve, do të jenë zyrtarët me kualifikime përkatëse, me njohuri të specializuar në infrastrukturën rrugore, që do të ofronin siguri se projektet janë realizuar nëpajtueshmëri të plotë me standardet e ndërtimit.	kemi identifikuar raste të pranimit të punëve nga komisione jo kompetente.	
22.	Investimet kapitale	inistri duhet të siguroj se zyrtari certifikues, gjatë procesimit të pagesave të sigurohet se në dosje është e bashkangjitur pjesa financiare e kontratës dhe certifikimi i pagesës do të bëhet vetëm në bazë të situacioneve të cilat paraqesin punët në mënyrë specifike që ndërlidhen me faturë dhe të dëshmuara me dokumentacionin relevant.	Ky rekomandim ishte zbatuar.	I zbatuar
23.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që të ndërmerren veprimet e nevojshme në menaxhimin dhe implementimin e projekteve për investime kapitale e në fokus të veçantë të jenë autoudhat si projekte madhore dhe komplekse në mënyrë që ekzekutimi i punëve të realizohet brenda afateve të parapara kohore. Para inicimit të projekteve, ministria duhet paraprakisht të pajiset me leje ndërtimore për projektet e caktuara ku kësaj procedure i paraprinë edhe realizimi i shpronësimeve të cilat parashihen për realizimin e projekteve.	Vonesat në realizimin e projekteve vazhdojnë të jenë të theksuara.	Nuk ka filluar zbatimi
24.	Investimet kapitale	Ministri të sigurojë se projektet e iniciuara realizohen sipas marrëveshjeve kontraktuale përkatëse dhe në rastet e vonesave të paarsyeshme të merren masat që parashihen me këto marrëveshje. Po ashtu, Ministri të sigurojë se NjZP është duke kryer funksionin e saj në përputhje me qëllimin për të cilin është themeluar.	Projekti është ndërprerë nga ana e ministrit të Financave, duke vendosur që kredinë ta ri-destinoj për ndonjë projekt tjetër infrastrukturor. Po ashtu, njësia ishte shuar nuk kishte kompensime.	I zbatuar
25.	Investimet kapitale	Ministri duhet të sigurojë që procedurat e përzgjedhjes së kompanisë mbikëqyrëse të realizohen në afat sa më të shkurtër kohor në mënyrë që të evitohen vonesat në realizimin e projekteve. Po ashtu, Ministri duhet të siguroj që planifikimi i buxhetit të bëhet në harmoni me kontratat e nënshkruara dhe planet dinamike të tyre.	Ministria kishte marr masat e duhura dhe për projektin “Zgjerimi i pistës, ngritja e sistemit instrumental ANP" ishte bere pranimi teknik i përkohshëm.	I zbatuar
26.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që zyra e prokurimit është duke mbikëqyrur zhvillimin e proceseve të prokurimit dhe realizimi i kontratave kryhet brenda kornizës ligjore. Në mënyrë specifike në	Nga testimi i disa mostrave kemi verifikuar se zyra e prokurimit në projektet kur	I zbatuar

		rastet kur paraqiten vonesa në realizimin e projekteve, të sigurohet se janë vazhduar siguritë e ekzekutimit për ato projekte.	ishin paraqitur vonesa në realizim, ishin siguruar që OE të sjellin siguritë e ekzekutimit të afatshme.	
27.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë: matjet gjeodezike, incizimin e gjendjes reale në terren, zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe përcaktimin e saktë të trashësisë së rrugëve. Në rastet e gabimeve me implikim financiar për MI-në, jo vetëm të kërkohet korrigjimi i tyre por edhe të aplikohen penalizime tek kompania projektuese.	Këto mangësi vazhdojnë të jenë evidente.	Nuk ka filluar zbatimi
28.	Investimet kapitale	Ministri të siguroj se nënshkrimi i kontratave nga zyra e prokurimit të bëhet në pajtueshmëri të plotë me afatet kohore të publikuara në njoftimin për kontratë.	Nuk kemi identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
29.	Pasuritë	Ministri duhet të siguroj se është finalizuar procesi i inventarizimit dhe është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare në mënyrë që të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive në RVF.	Raporti i inventarizimit ishte përpiluar por nuk ishte dërguar me kohë ashtu siç kërkohet me rregulloren e aplikueshme.	Pjesërisht i zbatuar
30.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të ndërmerr veprime për të identifikuar arsyet e vonesave në inkasimin e këtyre pagesave dhe dhe të krijojë mekanizma efektiv për inkasimin e borxheve nga debitorët.	Edhe gjatë vitit 2021, kemi vërejtur që ministria nuk kishte ndërmarrë hapa konkret për inkasimin e borxheve.	Nuk ka filluar zbatimi
31.	Obligimet e papaguara	Ministri duhet të siguroj që për çdo projekt ka fonde të mjaftueshme të planifikuara, në mënyrë që kjo të mos reflektohet në kryerjen e obligimeve ndaj OE. Njëkohësisht të rishikoj mekanizmat e kontrollit në sistemin e menaxhimit të faturave, ashtu që të gjitha pagesat e të bëhen në përputhje me afatet kohore ligjore.	Vonesat në pagesa ishin evidente edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi
32.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja NjAB dhe të sigurohet pavarësia e kësaj njësie.	Edhepse ishte themeluar KA nuk kishte qenë funksional as këtë vit.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Drejtor i Auditimit



Fjolla Bakalli, Udhëheqëse e ekipit



Burbuqe Idrizi, Anëtare e ekipit



Natyra Kasumaj, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



PRISHTINË / A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Data: 22/06/2022
Prishtinë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Me respekt,

Liburn Aliu
Ministër i Ministrisë së Mjedisit,
Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[7] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[8], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Pasuritë jo kapitale të regjistruara në SIMFK • Furnizim me kontenjere – investim ne vijim – vlera neto 221,000€ • Mobilje nën 1000€ - vlera neto (6,826€)

[5] Projektet e përfunduara te të cilat nuk ka filluar zhvlerësimi: Zgjerimi i rrugëve Brahim Ademi dhe Driton Islami (pranimi teknikishte bërë me datë 28.06.2019); Zgjerimi i rrugës rajonale R102 Segmenti Projekti Komoran-MorinëLlot 2 (pranimi teknik ishte bërë me datë 15.11.2019); Rikonstruktimi i rrugës lokale Hogosht-Lisock (pranimi teknik ishte bërë me datë 13.11.2015); Shtresimi me asfalt në rrugën Hajgobill, pranimi teknik ishte bërë me datë 30.09.2019); Ndërtimi i rrugës Vojnik-Osjan Lot 2, (pranimi teknik ishte bërë me 19.11.2018); Ndërtimi i rrugës Zaselle-Mitrovicë, (pranimi teknik ishte bërë me 31.12.2019); Ndërtimi i rreth rrotullimit në rrugën Nacionale Prishtinë Ferizaj- Banullë, (pranimi teknik ishte bërë me datë 04.08.2021) si dhe; Faza 2-Rregullimi i shtratit të lumit Krivareka deri te ura Domaroc –kolektori i ujërave te zeza nga Berivojc deri ne Koretin, (pranimi teknik ishte bërë me datën 24/12/2020). Projektet që nuk janë bartur në komuna: Projekti “ Unaza e jashtme në Ferizaj” , (pranimi teknik ishte bërë me datë 21/05/2021); Projekti “ Ndërtimi i nënkalimit në fshatin Varosh”, (pranimi teknik ishte bërë me datë 16/06/2021); Projekti “Ndërtimi i Rrugës Koshutan-Lekaj në Rugovë “, (pranimi teknik ishte bërë me datë 25/11/2021); Projekti “ Zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugës Prilep – Izniq”, (pranimi teknik ishte bërë me datë 14/09/2020; Projekti “ Asfaltimi i rrugëve ne Deçan” , (pranimi teknik ishte bërë me datë 14/09/2020); Projekti “ Asfaltimi i rrugës Plemetin-Millosheve dhe Rroga Ali Qerkiqi” , (pranimi teknik ishte bërë me datë 19/03/2021) si dhe Projekti “Ndërtimi i Memorialit Baza e Parë e UÇK-së Lladovc-Projekti Podujevë” , (pranimi teknik ishte bërë me datë 17/11/2017) .

[6] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[7] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[8] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.